

Nr. 4 Regj.

Durrës, më 09. 04. 2025

Lënda: Në përgjigje të kërkesës suaj.

**Qendra "Res Publica"***Adresa: Blv "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.7, Tiranë*

Në kuadër të implementimit të Ligjit Nr. 119/ 2014 "Për të drejtën e informimit" (i ndryshime), si dhe në referencë të kërkesës suaj, datë 07.04.2025, me objekt "Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit" e regjistruar në regjistrin e "Kërkesë/Ankesë/Përgjigje" në përputhje me nenin 8 të ligjit të sipërcituar me Nr. 4, ju informojmë për si vijon:

**1. Cila është gjendja aktuale e punimeve për hekurudhën Tiranë-Durrës me zgjatim në Rinas?**

Punimet për Projektin 'Rehabilitimi i Linjës hekurudhore Durrës-Tiranë kanë arritur në masën 82% . Po punohet intensivisht në të gjithë linjën duke përfshirë dhe linjën e re në drejtim të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA), ku brenda muajit Shtator do te perfundojne 100% punimet civile, perfs hire shina, traversa, nderruese dhe sinjalistika e jashtme.

**2. A ka nisur puna për ndërtimin e stacioneve të reja të hekurudhës?**

Kontrata për ndërtimin e stacioneve të reja hekurudhore përgjatë linjës hekurudhore Durrës-Tiranë-Rinas, do të firmosët brenda këtij muaji (10 Prill 2025) dhe punimet do të fillojnë menjëherë ne Prill 2025 dhe perfundojne ne Prill 2026.

**3. Cila është planvendosja e stacionit të planifikuar në Rinas dhe në çfarë faze ndodhen punimet në këtë stacion?**

Stacioni fundor i Rinasit ka pësuar një ndryshim nga pozicioni i mëparshëm. Planvendosja tashme është në një pozicion të ri për arsye të zhvillimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA) sipas Master Planit të Ri të miratuar të tyre. Gjurma përfundimtare e stacionit hekurudhor të Aeroportit është duke u finalizuar dhe do të jetë saktësisht përballë Forcave Ajrore- Albcontrol.

**4. Cilat janë pritshmëritë e projektit për vitin 2025?**

Brenda këtij viti do të përfundojnë plotësisht punimet civile të të gjithë projektit si të linjës ekzistuese Durrës-Tiranë, ashtu edhe të Linjës së Re Hekurudhore që po ndërtohet ne Aeroport. Gjithashtu ne fund te vitit 2025 do te jene te perfunduara gjysma e godinave hekurudhore.

*\*Autoriteti publik "Hekurudha Shqiptare" Sh.A, angazhohet në garantimin e të drejtës së informimit, si garanci kushetuese dhe vepron në mbështetje të ligjit Ligjit Nr. 119/ 2014 "Për të Drejtën e informimit" dhe trajton kërkesën tuaj në përputhje me Ligjin nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".*

Me konsideratë!

**KOORDINATORI I TË DREJTËS SË INFORMIMIT**

**Domeniko SINJARI**

**Domeniko  
Sinjari**



Digitally signed by Domeniko Sinjari

Date: 2025.04.09 14:58:41 +0200'

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se:

Vendosja në dispozicion e objektit të ish-universitetit "Kristal", për përballimin e situatës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, parashikohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.244, datë 26.03.2020 "Për vendosjen në dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të objektit të ish-universitetit "Kristal".

Me anë të Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 156/2, datë 11.03.2020 "Për shpalljen e gjendjes së epidemisë nga infeksioni COVID-19", është shpallur gjendja e epidemisë nga infeksioni COVID-19 deri në një urdhër të dytë.

Për sa më sipër, sjellim në vëmendjen tuaj se gjendja e epidemisë është ende në fuqi sipas Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 156/2, datë 11.03.2020, të sipërcituar.

Duke ju falënderuar,

Eduart Dedej

Specialist

Spektori i Shërbimeve të Përgjithshme, Çështjeve Juridike dhe Emergjencave

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

